



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.11.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Votimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015”
2. Votimi në parim i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.
3. Votimi në tërësi i projektligjit “Për faljen e kamatëvonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi”.
4. Diskutim i projektbuxhetit 2015 për institucionet: Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike, ILDKPKI, KQZ, Avokati i Popullit, Komisioni i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ISKPK.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Spartak Braho, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Tahir Muhedini, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Mhill Fufi, Eduard Halimi, Oerd Bylykbashi, Piro Lutaj, Armando Prenga, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Tom Doshi, Keltis Kruja, Kastriot Islami, Gjovalin Bzheta dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Milena Harito – ministre e Inovacionit dhe Administratës Publike.

Lorin Ymeri – shef kabineti i Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike.

Shkëlqim Ganaj – inspektor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.

Flori Karaj – sekretar i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.

Skënder Vrioni – sekretar i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Mirela Gega – drejtore e Financës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Igli Totozani - Avokat i Popullit.

Fatbardh Zenelaj - sekretar i Përgjithshëm pranë Avokatit të Popullit.

Ilirjan Lole – përgjegjës i Sektorit të Financës pranë Avokatit të Popullit.

Besnik Dervishi – komisioner për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Lindita Morina – drejtoreshë e Shërbimeve Mbështetëse pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Irma Baraku – komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ardiana Hala – drejtoreshë e Financës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Erion Lili – specialist finance pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Agron Tufa – drejtor ekzekutiv i Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

Zoica Plaku – drejtoreshë e Financës pranë Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

Pranvera Strakosha – komisionere e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil.

Gelardina Prodani – sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Financave.

Mimoza Dhëmbi – drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e
Financave.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillimisht duhet të bëjmë tri votime.

Votimi i parë është në parim për projektligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015”.

Meqenëse është mbyllur procesi, kush është dakord në parim? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.11.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Votimi në parim i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Spartak Braho, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Tahir Muhedini, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Mhill Fufi, Eduard Halimi, Oerd Bylykbashi, Piro Lutaj, Armando Prenga, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Tom Doshi, Keltis Kruja, Kastriot Islami, Gjovalin Bzheta dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Milena Harito – ministre e Inovacionit dhe Administratës Publike.

Lorin Ymeri – shef kabineti i Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike.

Shkëlqim Ganaj – inspektor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.

Flori Karaj – sekretar i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.

Skënder Vrioni – sekretar i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Mirela Gega – drejtore e Financës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Igli Totozani - Avokat i Popullit.

Fatbardh Zenelaj - sekretar i Përgjithshëm pranë Avokatit të Popullit.

Ilirjan Lole – përgjegjës i Sektorit të Financës pranë Avokatit të Popullit.

Besnik Dervishi – komisioner për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Lindita Morina – drejtoreshë e Shërbimeve Mbështetëse pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Irma Baraku – komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ardiana Hala – drejtoreshë e Financës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Erion Lili – specialist finance pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Agron Tufa – drejtor ekzekutiv i Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

Zoica Plaku – drejtoreshë e Financës pranë Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

Pranvera Strakosha – komisionere e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil.

Gelardina Prodani – sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Financave.

Mimoza Dhëmbi – drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Ndërkohë është për taksat kombëtare.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Jo, ta bëjmë vetëm në parim sot, se nen për nen do ta kalojmë...

Edhe paketa fiskale nen për nen, pastaj kalon.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Në parim.

Dakord në parim?

(Anëtarët e komisionit shprehen dakord.)

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.11.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Votimi në tërësi i projektligjit “Për faljen e kamatëvonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Spartak Braho, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Tahir Muhedini, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Mhill Fufi, Eduard Halimi, Oerd Bylykbashi, Piro Lutaj, Armando Prenga, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Tom Doshi, Keltis Kruja, Kastriot Islami, Gjovalin Bzheta dhe Fatmir Mediu.

Fatmir Xhafaj – Pastaj kemi propozimin e projektligjit “Për faljen e kamatëvonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi”. E kemi shqyrtuar në parim, kemi diskutuar, e kemi shqyrtuar nen për nen dhe tani kemi votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.11.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutim i projektbuxhetit 2015 për:

- Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike,
- ILDKPKI,
- KQZ,
- Avokati i Popullit,
- Komisioni i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil,
- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,
- Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Spartak Braho, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Tahir Muhedini, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Mhill Fufi, Eduard Halimi, Oerd Bylykbashi, Piro Lutaj, Armando Prenga, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Tom Doshi, Keltis Kruja, Kastriot Islami, Gjovalin Bzheta dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Milena Harito – ministre e Inovacionit dhe Administratës Publike.

Lorin Ymeri – shef kabineti i Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike.

Shkëlqim Ganaj – inspektor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.

Flori Karaj – sekretar i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.

Skënder Vrioni – sekretar i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Mirela Gega – drejtore e Financës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Igli Totozani - Avokat i Popullit.

Fatbardh Zenelaj - sekretar i Përgjithshëm pranë Avokatit të Popullit.

Ilirjan Lole – përgjegjës i Sektorit të Financës pranë Avokatit të Popullit.

Besnik Dervishi – komisioner për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Lindita Morina – drejtoreshë e Shërbimeve Mbështetëse pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Irma Baraku – komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ardiana Hala – drejtoreshë e Financës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Erion Lili – specialist finance pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Agron Tufa – drejtor ekzekutiv i Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

Zoica Plaku – drejtoreshë e Financës pranë Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

Pranvera Strakosha – komisionere e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil.

Gelardina Prodani – sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Financave.

Mimoza Dhëmbi – drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Fatmir Xhafaj – Të njoftohet media të jetë e pranishme.

Të njoftohet ministria.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me ministren e Inovacionit dhe Administratës Publike për buxhetin e shtetit të vitit 2015.

Prezentë kemi zonjën Milena Harito, ministre e Inovacionit dhe Administratës Publike dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave: sekretaren e Përgjithshme, zonjën Prodani, dhe drejtoreshën e Përgjithshme të Buxhetit, zonjën Dhëmbi.

Fillimisht do të dëgjojmë ministren për një përmbledhje të shkurtër të projektbuxhetit për fushën e përgjegjësisë së saj dhe në mënyrë të veçantë për pjesën që lidhet me ne, që ka të bëjë me administratën publike. Pastaj, do të vazhdojmë me pyetje nga kolegët, nëse do të kenë.

Zonja Ministre, fjala për ju.

Milena Harito – Faleminderit, zoti kryetar!

Në buxhetin e shtetit të vitit 2015 për pjesën e administratës publike, pra ajo që ka të bëjë me Komisionin e Ligjeve, përfshihet Departamenti i Administratës Publike dhe Shkolla e Administratës Publike.

Departamenti i Administratës Publike, siç e dini, gjatë këtij viti është përforcuar në mënyrë të rëndësishme. Pra, numri i punonjësve të tij është dyfishuar pikërisht, sepse i është kërkuar të implementojë ligjin e ri të nëpunësit civil, i cili e çon fushën e përgjegjësisë së Departamentit nga 3 000 persona, që ishte deri vitin e kaluar, në 9 000 persona.

Për këtë arsye, gjatë këtij viti është dyfishuar numri i punonjësve të Departamentit.

Për vitin në vijim, në Departamentin e Administratës Publike, në radhë të parë, do të bëhen disa investime bazike për pajisje për punonjësit e rinj që ka marrë Departamenti, që janë relativisht modeste në vlerë, por që janë të rëndësishme për të siguruar funksionimin real dhe konkret të të gjithë punonjësve.

Tjetër gjë është që për herë të parë këtë vit janë ngritur komisionet e përhershme të pranimit. Siç e dini, kjo ka lidhje me organizimin e konkurseve sipas ligjit të ri, të cilat bëjnë selektimin e kandidaturave për administratën. Për këto komisione është parashikuar një fond pagash, edhe ai relativisht modest, por i domosdoshëm për funksionimin e këtyre komisioneve.

Nga ana tjetër kemi Shkollën e Administratës Publike që, siç e dini, është gjithashtu risi e ligjit të ri të nëpunësit civil. Ajo ka për detyrë të zhvillojë një numër shumë të madh trajnimesh për punonjësit e administratës, për trupën e nivelit të lartë drejtues dhe në të gjitha nivelet. Sigurisht është garantuar buxheti edhe për Shkollën e Administratës Publike, për funksionimin e saj edhe në vitin në vijim. Kjo është për sa i përket administrimit të buxhetit për administratën publike.

Po e them këtu, ndonëse nuk është shqetësim kryesor në këtë komision, sidoqoftë mendoj se është një risi shumë e rëndësishme e buxhetit dhe e rëndësishme që ta themi edhe këtu, që për fushën e inovacionit dhe të teknologjisë së informacionit, për herë të parë, është vendosur të ketë një buxhet të qendëruar.

Ndoshta, siç e keni parë në vitet e mëparshme, ky lloj buxheti ka qenë i shpërndarë në ministritë e ndryshme të linjës. Një nga efektet e kësaj është që shteti ynë e kishte të vështirë të vlerësonte sa shpenzonte në këtë fushë. Për këtë arsye, për të hyrë edhe në kriteret e parametrave ndërkombëtare, që kërkojnë të dihet sa shpenzon një shtet në fushën e teknologjisë së informacionit, është vendosur që ky buxhet të qendëruhet. Ky është një buxhet i rëndësishëm në këtë vit që është futur në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve. Pra, jepet mundësia në këtë Fond të aplikohet edhe për të gjithë fushën e Shqipërisë dixhitale. Është një risi reale, sepse ndodh për herë të parë dhe, sigurisht, aplikimi i atij Fondi pastaj do të jetë nga aplikuesit e tij. Pra, nuk është se Fondi aplikon projektimin dhe dizajnimin, por do të kemi një vizion të qendëruar të këtij Fondi, që do të na lejojë të investojmë në fushat që do të konsiderohen prioritare në vizionin politik të maxhorancës sonë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Ka pyetje për ministren për buxhetin?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Harito!

Pyetja ime ka të bëjë me pjesën e trajnimit të administratës publike. Ligji i ri kërkon që punonjësit e administratës të kalojnë në trajnim. A është i mjaftueshëm fondi i parashikuar nga qeveria për të përballuar edhe shtesën e nëpunësve civilë, të cilët e përfitojnë këtë status në bazë të ligjit “Për nëpunësin civil”?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zonja Ministre.

Milena Harito – Patjetër që po. Fondi është parashikuar në mënyrë që ta mbulojë këtë detyrim dhe, më tepër se kaq, të krijojë edhe mundësinë që të fusim testimin online për punonjësit, në mënyrë që ta bëjmë procedurën e trajnimit, më pas edhe të testimit të tyre, sa më transparente. Kështu që është parashikuar një fond që do të mbulojë edhe testimin online të të gjithë punonjësve.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Pyetja e dytë: me fondin që ka parashikuar qeveria, a mbyllet sivjet futja në një sistem regjistrimi i të gjithë nëpunësve civilë, edhe të institucioneve qendrore, edhe të agjencive të varësisë?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Ministre.

Milena Harito – Kjo është pyetje shumë me vend dhe më vjen mirë që e bëni, sepse kjo është një çështje që e ngre vazhdimisht edhe Komisioni European, përveçse është shqetësim i rëndësishëm yni.

Ne kemi të dhëna sot mbi administratën civile, pra për ata që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, dhe një nga kërkesat e Komisionit është që ne të bëjmë raportim sistematik për të gjithë administratën publike, siç e kanë të gjitha vendet e zhvilluara. Për këtë arsye, sistemi duhet të shtrihet në të gjitha institucionet. Ka një pjesë relativisht të vogël, që mund të merret nga buxheti i shtetit, por kjo po bëhet me ndihmën e partnerëve dhe kryesisht të Bankës Botërore.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Zoti Fino?

Bashkim Fino – Mos ka Ministria e Financave, se unë nuk kam ndonjë gjë.

Fatmir Xhafaj – Unë jam i detyruar që...

Bashkim Fino – Aq më tepër që ministrja e tha se “më shumë do të flas te Komisioni i Ekonomisë, se këtu mirëkuptohem mirë me ju”.

Fatmir Xhafaj – Unë nuk dëgjova se e tha ashtu.

Milena Harito – E thashë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Faleminderit, zonja Ministre!

Besoj se do të shihemi javën e ardhshme me projektligjet që keni.

Milena Harito – Shumë faleminderit për ftesën!

Fatmir Xhafaj – Me buxhetin e mbyllëm, kështu që vazhdojmë me pjesën tjetër.

Fatmir Xhafaj – Tani kemi Inspektoratin e Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit. Prezentë kemi inspektorin e Përgjithshëm, zotin Ganaj dhe sekretarin e Përgjithshëm, zotin Karaj.

Zoti Ganaj dhe zoti Karaj, përshëndetje dhe mirë se keni ardhur!

Ju lutem, na bëni një prezantim të shkurtër të projektit dhe eventualisht nëse ka kërkesa të mundshme rreth tij, pretendime nga ana juaj, jeni të mirëpritur për t'i parashtruar!

Kush do ta parashtrojë? Zoti Ganaj.

Po, faleminderit!

Shkëlqim Ganaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Përveç atyre që janë përcaktuar në projektbuxhetin e ri, ne kemi kërkuar edhe një fond prej 3,2 milionë lekësh të rinj në zërin “investime” që janë tepër të rëndësishme

dhe për mua të panegociueshme, sepse kanë të bëjnë me sistemin elektronik bazë të të dhënave të institucionit, i cili është tërësisht i amortizuar, pasi është dhuruar që në vitin 2004 nga USAID-i. Sipas specialistëve duhet të rinovohet çdo tre vjet. Ky ka dhjetë vjet që nuk është vënë dorë. Ka vazhdimisht një rënie të sistemit nga ku humbet puna e gjithë vitit.

Lidhur me të katër serverët, se për katër serverë të rinj bëhet fjalë, për dy kemi rënë dakord dhe kërkojmë edhe dy të tjerë për t'i rinovuar të gjithë njëkohësisht, se ndërro dy dhe mbaj dy të vjetër, ose ndërro tre dhe mbaj një të vjetër, zëre se nuk ke bërë gjë dhe lekët që do të shpenzohen do të shkojnë dëm. Kështu që ndërrimi i të gjithë aparateve nga e para është tepër i domosdoshëm.

Së dyti, për shkak të ngarkesës së madhe që kemi, ju kemi bërë me dije më parë se kemi katërfishuar numrin e kontrolleve.

Është e nevojshme që minimalisht të shtohen shpenzimet korrente për inspektorë të lartë dhe tre ndihmësinsektorë, për të përballuar fluksin e madh të punës.

Për më hollësisht do të flasë sekretari i Përgjithshëm, që është edhe specialist i kësaj fushe.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ganaj!

Zoti Karaj, fjala për ju, por vetëm fokusohuni.

Flori Karaj – Inspektorati i Lartë gjatë këtij viti ka punuar për të risjellë në nivelet dhe standardet e kërkuara ligjore aktivitetin institucional.

Shpenzimet korrente që ne kemi kërkuar, si institucion nga ana e ministrive dhe e Këshillit të Ministrave në projektligjin përkatës, janë miratuar tërësisht, çka tregon një vlerësim për institucionin e ILDKP-së.

Gjithashtu, në zërin “investime” nga 8 milionë lekë, ne kërkojmë 11 milionë e 280 lekë, të cilat, ashtu siç tha inspektori i Përgjithshëm, kryesisht do të shkojnë për rinovimin e pajisjeve elektronike, veçanërisht për serverët, të cilët janë pothuajse jashtë përdorimit. Kanë 10 vjet përdorim, ndërkohë që duhet të ishin ndërruar mbi tri herë.

Kostoja e këtyre investimeve është 3 milionë e 280 mijë lekë, të cilat i mbulojmë vetëm nga të ardhurat nga gjobat. Ne kemi bërë të mundur që të realizojmë një mundësi

të ardhurash për buxhetin prej 26 milionë e 800 mijë lekësh. Kjo shtesë në investime përbën vetëm 5% të këtyre të ardhurave.

Gjithashtu, në dokumente nuk është kërkuar, është kërkesë e kohëve të fundit pas një analize që inspektori i Përgjithshëm bëri me gjithë stafin dhe me arritjet e deritanishme të 1,400 kontrolleve të ushtruara në institucionin tonë, nga 350 që janë ushtruar gati çdo vit, domethënë gati pesë herë më shumë, u gjykua e nevojshme dhe e domosdoshme që të shtohen në strukturë edhe tre inspektorë të lartë dhe tre ndihmësinpektorë të Lartë.

Struktura është po ajo. Domethënë, nuk ka nevojë për ndryshime, pasi struktura është e njëjtë, por ka nevojë vetëm për shtim në organikë: tre inspektorë dhe tre ndihmësinpektorë.

Kostoja e kësaj shtese është 9 milionë e 400 mijë lekë paga dhe 1 milion e 300 mijë lekë sigurime shoqërore, që bëjnë gjithsej 10 milionë e 700 mijë lekë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Tani, kjo pjesa e fundit, në qoftë se numrin e kanë njësoj dhe duan të bëjnë ndryshim strukture, ta ndryshojnë strukturën. Në qoftë se kërkojnë numër punonjësish shtesë, po.

Fatmir Xhafaj – E tha gabim ai, keni të drejtë!

Bashkim Fino – Ai tha se “nuk kemi nevojë për numër shtesë, por thjesht kemi nevojë të shtojmë inspektorët”.

Fatmir Xhafaj – Nuk ka gjë.

Bashkim Fino – Në qoftë se ai nga një ndihmësinpektor, nuk e di si e ka strukturën, pse duhet ta bëjë...

Fatmir Xhafaj – Jo, jo.

Bashkim Fino – Tani, unë mendoj që kërkesat e Inspektoratit janë, le të themi modeste, pavarësisht se duhet vlerësuar Ministria e Financave, sepse investimet nga 4 milionë i ka bërë në 8 milionë. Pra, për hir të së vërtetës, i ka dyfishuar investimet në

raport me shumë institucione që janë këtu te Komisioni i Ligjeve, kanë pasur aty-aty investimet, madje nuk kanë pasur më shumë investime.

Kështu që me shkresat që keni sjellë ju, unë fola edhe me zonjën Dhëmbi dhe besoj se shuma 1 milion lekë për blerje serverësh, rikonstruksioni i ashensorit apo për godinën janë gjëra shumë të vogla, që mund të shikohen dhe t'i kenë parasysh.

Nuk e di për këtë pjesën tjetër që kërkon tani rishtazi më shumë, por unë mendoj: nuk ju mjafton 8 milionëshi për të bërë gjithë këtë gjë?

Shkëlqim Ganaj – Duhet patjetër shtesa 3,2 milionë një herë për sistemin e IT-së, përveç shtesës që kërkuam për numrin e punonjësve...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, jo, është e pamundur, ndërkohë që 30% e njerëzve aty janë me kompjuterë të degraduar! Atij institucioni po i hoqe bazën e të dhënave, nuk quhet më institucion.

Aktualisht, ne nuk ruajmë dot më të dhëna sot. Nuk gjeneron, nuk mban fare sistemi. Domethënë, është tërësisht i degraduar. Ai duhet të rinovohet çdo tre vjet, ndërkohë që ka që në vitin 2004 që nuk është i prekur me dorë. Është e pamundur të punojë më.

Sa për defektet, nuk është puna se ai është defekt teknik, por çdo defekt teknik ka pasojat e rënda në punën e...

Fatmir Xhafaj – Në rregull, faleminderit!

Zoti Braho ka kërkuar fjalën.

Spartak Braho – Pa dyshim, ky institucion duhet mbështetur, sepse atje ka disa vite që nuk janë degraduar... vetëm kompjuterët. Ai institucion kishte degraduar edhe si funksion i tij, bashkë me atë që e drejtonte. Prandaj, unë jam dakord me atë që tha zoti Fino: ta mbështesim institucionin me ato mundësi që ka Ministria e Financave. Bëni çmos, shtrëngohuni ku të doni, por ne këtë institucion duhet ta sjellim në parametra pune!

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Faleminderit, zoti Braho!

Fjalën e ka zoti Manja.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti kryetar!

Inspektori i Përgjithshëm ishte këtu në këtë komision para disa ditësh, ku raportoi për progresraportin dhe unë e kam pyetur shprehimisht: “A është i nevojshëm shtimi i numrit të inspektorëve dhe ndihmësve në këtë institucion, për shkak të fluksit dhe të ngarkesës që ka?” dhe kam marrë një përgjigje: “Për momentin duhet të konsultohem me stafin për të parë kapacitetet se deri ku mund të arrijmë me stafin aktual”.

Më vjen mirë që sot kërkohet kjo shtesë në numrin e punonjësve, me sa kuptova për tre inspektorë dhe tre ndihmësinsektorë, dhe kërkoj nga kolegët e Komisionit të Ligjeve dhe mirëkuptimin e Ministrisë së Financave që të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për t’ia dhënë këtë ndihmë, sepse unë vazhdoj ta konsideroj si një institucion kyç në luftën kundër korrupsionit.

Pra, në qoftë se në progresraportin e Bashkimit European për vitin 2014 për Shqipërinë thuhet: “duhet rritur efienca e luftës kundër korrupsionit”, ky është institucioni, një nga agjencitë më të rëndësishme së cilës duhet t’i jepet ky lloj suporti.

Duke shkuar në të njëjtën linjë me kolegët parafolës, zoti kryetar, ftoj kolegët e komisionit që t’i japin mbështetje kësaj kërkesë, përpos edhe të gjitha kërkesave që ka bërë për infrastrukturën.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Tani, me sa shoh unë, të gjithë janë pro kërkesave modeste të bëra nga Inspektori i Përgjithshëm, si për çështjen e nevojës për një shtesë të vogël për disa investime të domosdoshme, që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe konsolidimin e bazës së të dhënave dhe kushteve më të mira të punës, ashtu edhe për shtimin e tre inspektorëve dhe tre ndihmësinsektorëve. Është normale.

Unë e mbështes dhe jam shumë dakord me atë që tha relatori dhe kolegët që ashtu siç shtojmë njëmijë e ca policë apo gardianë, që bëjmë mirë nëse është e nevojshme, absolutisht do të shtojmë ata që kanë për detyrë, në radhë të parë, të luftojnë korrupsionin.

Le të heqim disa nga ata që bëjnë korrupsion gjithë ditën dhe t’ia japim Inspektoratit të Lartë që lufton korrupsionin, edhe në shenjë vlerësimi për të gjitha ato rezultate pozitive...

(Deputeti Majko ndërhyr pa mikrofon.)

Për eficiencyn, dakord jam, zoti Majko, e shprehur nga ky institucion gjatë këtij viti që është njëkohësisht edhe një lloj nxitjeje, inspirim për të gjitha institucionet e tjera që kanë për detyrë luftën kundër korrupsionit.

Dakord zoti Fino ta mbyllim përfundimisht?

Bashkim Fino – Vetëm një arsye tjetër pse mund t’ia bëjmë këtë, pavarësisht se 4 milionëshin e vitit 2014 mund t’ia bëjmë 11,2 milionë, sepse në fund të fundit vitin që vjen, kur të kalojë buxheti, nuk do të kërkojë më kaq shumë investime, sepse e bëri këtë investim dhe natyrisht do të ketë një investim më të vogël. Ndaj, nëse duhen bërë këto, le të shtrëngohemi t’ia japim këtë 11,2 milionëshin dhe e zgjidhim përfundimisht këtë institucion dhe nuk kemi më probleme.

Fatmir Xhafaj – Edhe punonjësit besoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mark Frroku – Nuk kam çfarë të shtoj më shumë sesa kolegët, por unë do të isha i mendimit të shtonim 7 mijë dollarë, sepse serverët mund t’i blejmë, por në qoftë se nuk kanë një UPS t’i mbrojnë ato, vitin tjetër do të prishen prapë ato. Do të ishte mirë të blihej një UPS me vlerë 7 mijë dollarësh që i mbron ato dhe i ruan nga luhajtjet e energjisë elektrike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në qoftë se i ka llogaritur drejtori, është histori tjetër. Në qoftë se nuk i ka llogaritur, unë mendoj të shtohet 7 mijë dollarë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Gelardina Prodani – Ne do t’i mbajmë shënim dhe do t’i akordojmë pastaj. Do të flasim.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ganaj! Faleminderit, zoti sekretar i Përgjithshëm! Punë të mbarë!

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë.

Kemi të pranishme komisioneren e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, zonjën Pranvera Strakosha.

Kjo është hera e dytë që zonja Strakosha vjen në komision. Herën e parë për të marrë besimin e komisionit, ndërsa sot për të marrë paratë nga buxheti. Edhe besim, edhe para, pastaj mbetet vetëm që të punojë më mirë komisionerja, për shkak pritshmërive të larta që ka ndaj këtij institucioni.

Zonja Strakosha është për herë të parë në komision për të raportuar dhe për t'u dëgjuar, si komisionere. Kështu që për ta orientuar, besoj se stafi bashkë me Njësinë e Monitorimit në Kuvend mund t'ju ketë përgatitur diçka të përmbledhur për buxhetin e parashikuar dhe eventualisht nëse ka diçka që meriton vëmendjen e komisionit dhe të Ministrisë së Financave.

Fjala për ju.

Pranvera Strakosha – Ju faleminderit, zoti kryetar!

Si komisionere në këtë detyrë jam zgjedhur në datën 30 tetor me vendim të Kuvendit dhe, siç mund të merret me mend, ishte një situatë që tashmë projektbuxheti ishte planifikuar.

Me marrjen e projektbuxhetit konstatova se ishte ruajtur e njëjta situatë si ajo me Komisionin e Shërbimit Civil. Pra, nuk ishte marrë parasysh ndryshimi i ligjit, fakti që janë shtuar si nëpunës civilë, nga 7 500 rreth 20 000 punonjës, fakti që janë shtuar institucionet, kanë ndryshuar dhe mund të them se janë shtuar kompetencat e komisionerit. Pra, në krahasim me Shërbimin Civil, i cili ishte pothuajse si një gjykatë për pjesën më të madhe të ankimimeve, tashmë komisioneri ka një rol më aktiv (nuk ka rolin e gjykatës), duke filluar që nga mbikëqyrja, që nga vëzhgimi, që nga inspektimi për të vazhduar pastaj me hetimin administrativ, me vendimmarrjen dhe detyrimisht, duke dalë edhe si palë në gjykatë për ato subjekte që do t'i kundërshtojnë këto vendime.

Tani, numri është lënë i njëjtë dhe buxheti është lënë i njëjtë.

Unë në fakt kam paraqitur një variant, për mendimin tim, minimal (besoj se ashtu do të konsiderohet edhe nga ju), pavarësisht se me DAP-in kam konsultuar dy

variante të organikës. Pra, unë desha ta vija theksin vetëm te rritja e buxhetit për sa i përket numrit të punonjësve, sepse 24-a mendoj se ishte një numër shumë i kufizuar.

Me një organigramë të thjeshtë dhe që mendoj se është më se normale dhe minimale, unë kam kërkuar që minimalisht të shtohen 8 persona me një efekt në buxhet prej 3,100 000 lekësh. Kjo ishte ajo që unë kërkoja, pavarësisht se në një organigramë pak si më të zgjeruar, në konsultim me DAP-in, ishte me një optimale 37 persona me një efekt pak më të rritur në buxhet.

Përveç kësaj, konstatova se Komisioni i Shërbimit Civil kishte bërë pak shërbime jashtë Tiranës, që do të thotë mbi 100 kilometra, që janë vendimet, duhet të trajtohen edhe me dietë. Ata kishin bërë shumë pak dhe në fakt, fondi i shërbimeve është shumë i vogël. Në shkresën që i kam dërguar komisionit, unë nuk i kërkoja, por në fakt do të ishte normale, 1 milion e 500 mijë lekë, sikur inspektorët të bënin një herë në vit inspektim në të gjitha institucionet. Kjo ishte një llogari shumë e thjeshtë, që bëri zyra e Financës.

Mendoj se do të ishte shumë i rëndësishëm një fillim i mbarë i komisionerit, një fillim me mbikëqyrje. Kemi certifikimin e punonjësve dhe shumë institucione që hyjnë për herë të parë në shërbimin civil. Besoj se fillimi i mbarë, është gjysma e punës. Unë mendoj, se me përgatitjen dhe me marrjen e statusit, duhet të fillojmë me urgjencë inspektimet, sidomos, në pushtetin vendor, të cilët janë disi më pak të orientuar për procedurat.

Bashkim Fino – Unë kam një vërejtje parimore, meqë ky është një institucion shumë i ri. E dëgjova komisioneren dhe i uroj suksese. Nuk ka të bëjë me pushtetin lokal, sepse ai është drejt ristrukturimit dhe pas 6 muajsh, nuk do të kesh më 400 njësi, por do të kesh 61 bashki dhe do të kesh akoma më shumë mundësi të për të kontrolluar. Nëse ne miratojmë strukturën, si parlament dhe si komision, mendoj se duhet miratuar struktura, para se të kalojë buxheti. Fakti që Ministria e Financave ka lënë po atë buxhet që ka qenë, është nisur nga kjo, sepse shikoj sot edhe një organikë të Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil. Në pamje të parë mund të kem shumë vërejtje, por mund të jetë edhe në rregull. Problemi është që duhet të miratohet kjo organikë dhe duhet të zgjidhim, si do të jetë organika me këtë funksion të ri, që ka marrë Komisioneri

i Shërbimit Civil dhe pastaj të koordinojmë me KM-në. Ju mund të thoni se mbase nuk kemi kohë. Ndoshta, edhe mund të kemi kohë deri në datën 27 nëntor, kur kalon buxheti nën për nën. Me miratimin e organikës, bëhet edhe një konsultim i fundit me Ministrinë e Financave (meqë është institucion i ri), qoftë për numrin e punonjësve, për organigramën, qoftë edhe për shpenzimet (mund të jenë të drejta mendimet e komisionarit) dhe pastaj, lëmë një shumë që ka miratuar sot Ministria e Financave dhe kur ta diskutim nën për nën, ta diskutojmë edhe në funksion të organigramës së re, për ta futur përfundimisht, meqë u kap si institucion i ri, brenda pjesës që do të miratojmë buxhetin. Prandaj them se duhet ndarë diskutimi për organigramën, të cilën e kemi në dorë ta diskutojmë apo miratohet direkt nga komisioneri dhe pastaj, duhet të diskutojë edhe Ministria e Financave për këtë gjë.

Kam një vërejtje në parim. Nuk e kam konkretisht për komisioneren, sepse ajo është zgjedhur e re, por kemi pasur Komisionin e Shërbimit Civil me 4-5 komisionerë dhe shumë punonjës që punonin aty. Tani do të kemi vetëm një komisioner dhe jo pesë. Nga kjo pikëpamje, ka një funksion pune tjetër (me ç'di unë), se tani do të punojë Gjykata Administrative. A do të ketë përsëri të njëjtin numër punonjësish, siç e kishte Shërbimi Civil i dikurshëm? Unë mendoj se duhet të jenë më pak.

Komisionerja tha se duhen akoma më shumë. Unë nuk jam në gjendje të them se kjo shumë që është vënë apriori nga Ministria e Financave, është vënë kështu, sepse as ajo nuk e ka ditur organigramën e komisionit të ri. Prandaj, të mos nxitohemi, të miratohet njëherë organigrama dhe deri në datën 27 që kalon nën për nën projekt-buxheti, mund ta kalojmë. Ky është propozimi im.

Megjithatë, këtë e keni në dorë ju.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Kam një pyetje për Shërbimin e Monitorimit: strukturën e miraton komisioni apo...?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Në rregull.

Faleminderit!

Nuk e di nëse kolegët kanë ndonjë gjë tjetër, por mua më duket racional, propozimi i zotit Fino.

Atëherë, të hënën do të shqyrtojmë strukturën. Duam një koment të DAP-it, një koment të Drejtorisë së Monitorimit dhe një koment të Ministrisë së Financave. Kjo do të thotë që menjëherë mbas kësaj mbledhjeje, komisionerja, DAP-i dhe Ministria e Financave të ulen në tryezë dhe të komisioni të hënën, gjatë seancës, të shkëputet për ta shqyrtuar në mënyrë që të kapim votimin nen për nen të buxhetit, në mënyrë që të përputhim strukturën e re me buxhetin e ri.

Jeni dakord?

Kishit ndonjë gjë, zonja Strakosha?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Mendoj se nuk është e nevojshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ju lutem! Duhet të sqaroni zotin Peza, që do të jetë relator për këtë çështje, Ministrinë e Financave dhe DAP-in. Po t'i sqarosh mirë këta të tre, së bashku me Drejtorinë e Monitorimit, na ke sqaruar edhe ne.

Faleminderit, zonja Strakosha dhe punë të mbarë!

Me zotin Peza, mund të takoheni tani.

Zoti Peza, do t'ju lutesha ta monitoroni të gjithë këtë proces!

Faleminderit, zoti Peza!

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Edhe një herë, me strukturën do të merret ai dhe pastaj, do të vijë për buxhetin. Ai do të mbrojë strukturën dhe ju do të keni buxhetin.

Fatmir Xhafaj – Në seancën e radhës është i pranishëm zoti Besnik Dervishi, Komisioner për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ju falënderoj, zoti Dervishi për prezencën tuaj!

Do të dëshironim një paraqitje të shkurtër nga ju për parashikimet që ka bërë projekt-buxheti dhe eventualisht, nëse ka diçka që duhet të sistemohet më mirë në parashikimet e bëra nga qeveria lidhur me projekt-buxhetin e institucionit tuaj.

Urdhëroni, zoti Dervishi!

Besnik Dervishi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Konstatoj se projekt-buxheti është hartuar duke mbështetur një rritje të veprimtarisë së komisionerit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, por nga ana tjetër, për shkak edhe të periudhës, kur është hartuar (projekt-buxheti është hartuar para se të miratohej ligji “Për të drejtën e informimit”), konstatohet që nuk është marrë në konsideratë pjesa që i përket veprimtarisë së komisionerit për sa i përket së drejtës së informimit. Mbështetja financiare e dhënë, konsiston në shtimin e numrit të punonjësve në strukturë, me 3 punonjës në nivel specialisti, shtimin e kuotave për shpenzime operative, që konkretisht i takojnë për herë të parë në vendin tonë të Konferencës për Vendet e Europës Qendrore e Juglindore në Fushën e të Dhënave Personale, në shumën 2 milionë lekë, si dhe në infrastrukturë dhe logjistikë, për shkak të transferimit të ambienteve të punës. për hir të së vërtetës, institucioni i komisionerit e zhvillon veprimtarinë në ambiente krejtësisht të papërshtatshme. Shpresojmë që vitin e ardhshëm, të kemi një mundësi më të mirë.

Argumentet bazë ia adresojmë kryesisht monitorimit dhe përpunimit të të dhënave personale për shkak të zhvillimit të vrullshëm të teknologjisë së informacionit, përdorimit në rritje të sistemeve CSV, përdorimit të të dhënave biometrike, kryerjes së transmetimeve ndërkombëtare të të dhënave personale, përpunimit të *big data*, ndërveprimit të bazave të të dhënave, janë të gjitha veprimtari, të cilat aktualisht janë të pambuluara me personel nga ana e komisionerit dhe ne jemi të detyruar për shkak të vetë punës, të detyrimeve ligjore dhe për shkak të detyrimeve ndërkombëtare, t’u përgjigjemi me ekspertizë të kualifikuar.

Miratimi i ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe miratimi i ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” kanë parashikuar monitorimin e tyre nga zyra e Komisionerit, e cila tashmë do të quhet: Zyra për të Drejtën e Informimit dhe

për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në të tilla kushte, në shtim të kompetencave të veprimtarisë së komisionerit, ndjekja e zbatimit të këtyre të drejtave mbetet tërësisht e pambuluar me burime njerëzore, investime, pajisje zyresh, logjistikë, apo kuota të shpenzimeve operative.

Nevoja e forcimit të burimeve njerëzore për monitorimin e së drejtës së informimit është e përmendur edhe në ligjin “Për të drejtën e informimit”, gjithashtu, është rekomanduar dhe në progres-raportin e BE-së për vitin 2014 dhe në projekt-raportin e vëzhguesve të institucioneve të pavarura të Komisionit European.

Në përfundim, në mbështetje të kërkesave tona për rritje të buxhetit financiar, në mbështetje të kompetencave të shtuara, duhet të mbështetet një shtesë e burimeve njerëzore, të cilën unë e kam lënë të papërcaktuar në materialin që u kam dërguar, sepse kjo do të vendoset nga ju, por ne kemi bërë një parashikim edhe me katër persona të tjerë, e cila minimalisht, i plotëson kërkesat që ne kemi. Natyrisht, në periudhën në vazhdim, do të bëjmë edhe vlerësimet e duhura. Gjithashtu, për shpenzime operative në shumën 3 milionë lekë dhe në zërin shpenzime kapitale dhe investime, në shumën 1 milion lekë.

Dua të them se këto i korrespondojnë vetëm shtesës për pjesën e burimeve njerëzore, që mendoj se do të shtojmë i përkasin veprimtarisë së të drejtës së informimit.

Ky është prezantimi në mënyrë telegrafike. Do të kërkoja mbështetjen tuaj, si një institucion me detyra të reja, që natyrisht, kërkon t’u përgjigjet detyrave që shtron momenti dhe procesit mjaft të rëndësishëm të integritetit të vendit tonë.

Dua të theksoj se është hera e parë që ky institucion ka marrë përsipër organizimin e një konference ndërkombëtare mjaft të rëndësishme, ku do të marrin pjesë rreth 20 autoritete të mbrojtjes së të dhënave personale, ndërkohë, kemi në program që kjo të shërbejë si provë gjenerale për të organizuar konferencën botërore të autoriteteve, gjë që do të ishte mjaft e rëndësishme për institucionin tonë, por edhe për të gjithë vendin.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Dervishi!

Ka pyetje nga kolegët?

Zoti Fino, keni fjalën!

Bashkim Fino – Unë kam pyetje dhe evidencën e kam përpara. Zoti Dervishi duhet të jetë shumë i kënaqur, sepse shikoj të dhënat, të cilat janë shumë impresionuese: totali i shpenzimeve në vitin 2014 ka qenë 47 milionë dhe në vitin 2015 do të jetë 64,8 milionë, pra, ka rritje të konsiderueshme.

Shpenzimet korrente nga 46 milionë, që ishin në vitin 2014, shkojnë në 50,8 milionë në vitin 2015.

Ajo që më kënaq më shumë, dhe që plotëson kushte e komisionerit, janë investimet, të cilat janë planifikuar 1 milion lekë në 2014-ën, në 2015-n janë parashikuar 14 milionë (për rregullime e të tjera me radhë). Nga evidencat që kam thuhet se është kërkuar për zgjerimin e aktivitetit me 7 punonjës, me 72 milionë lekë ndërkohë, i janë akomoduar shtesa për 3 veta, pra ishte numri 29 dhe do të bëhet 32.

Me ç'shikoj, Ministria e Financave i ka realizuar pak a shumë, i ka pranuar të gjitha ato që ka kërkuar Komisioneri, me përjashtim të numrit të personelit shtesë që është kërkuar 7 dhe ministria i ka shtuar vetëm 3 dhe unë besoj, se do të vijmë në një zgjidhje.

E vetmja gjë që mbetet për të parë nëse Ministria e Financave ka ndonjë hapësirë për të shikuar, janë shpenzimet operative për të cilat kërkohen edhe 3 milionë lekë, por që në fakt, shpenzimet korrente kanë rritje.

Edhe po ta kalojmë kështu siç është këtu, është mjaft mirë. Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë kanë punuar mjaft mirë. Nuk e di nëse komisioneri ka ndonjë gjë pikante, që ne mund t'ia zgjidhim këtu, hajde t'ia zgjidhim në raport të kësaj evidence që kemi këtu, sepse e dimë, të gjithë bëjnë kërkesa maksimale (Besniku e di, se ka qenë drejtues i vjetër dhe njihet kjo metodë) dhe kur marrin diçka në fund, mbeten të kënaqur. Nuk e di, po kjo evidencë këtu më duket se i plotëson dëshirat.

Besnik Dervishi – Faleminderit, zoti Fino!

Është e vërtetë që me Ministrinë e Financave kemi pasur negociata dhe unë i falënderoj që i kanë marrë në konsideratë, duke marrë parasysh mundësitë dhe kapacitetet që ata kanë. Nëse do të hyjmë në detaje, do të shikojmë që për këtë vit

shpenzimet operative kanë qenë 13 milionë lekë dhe këtë vit që vjen, janë parashikuar 15 milionë lekë. Janë kaq, sepse 2 milionë lekë janë parashikuar për organizimin e konferencës, pra, po ta shikojmë në shifër, 13 milionë kanë qenë vitin e shkuar dhe po aq kanë mbetur, sepse 2 milionë lekë janë parashikuar për organizimin e konferencës, që është e planifikuar dhe që janë shpenzime të programuara. Megjithatë, s’kam pretendime, sepse jemi në rregull për veprimtarinë e mbrojtjes së të dhënave personale, jemi në rregull, por do të shtohet struktura e të drejtës së informimit (të paktën një drejtori). Të drejtën e informimit do ta mbështesë e njëjta drejtori juridike që ekziston dhe e njëjta drejtori e shërbimeve mbështetëse, por duhet thelbi i drejtorisë për të drejtën e informimit. Në këtë këndvështrim, kërkoj mbështetjen edhe me 4 persona të tjerë, sepse nuk plotësohen funksionet që parashikon vetë ligji “Për të drejtën e informimit”. Unë s’mund të heq punonjës të specializuar për mbrojtjen e të dhënave personale dhe t’i kaloj në funksionet për të drejtën e informimit. Kjo s’do të ishte as serioze që një punonjës i specializuar për mbrojtjen e të dhënave personale, ta kaloj për të drejtën e informimit. Kjo nuk do të ishte serioze, sepse nuk do të bënte as një të tjetër dhe as tjetër.

Përderisa, është bërë një investim mjaft i mirë me miratimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”, mendoj se duhej bërë një sforcë e vogël për vetëm 4 persona, që ta vazhdojmë mbarë këtë punë, ashtu siç ka filluar dhe që është mbështetur veçanërisht, nga ky komision.

Për sa i përket investimit shtesë prej 1 milion lekësh në zërin investime, janë thjesht pajisja e zyrave dhe logjistika për këta persona shtesë. Nëse do të mbetet edhe kjo, natyrisht, do të bëjmë si do të bëjmë me ato investime që janë parashikuar dhe e mbyllim.

Unë e falënderoj Ministrinë e Financave për shifrën që ka dhënë, megjithëse mund të jetë e pamjaftueshme. Po të shikoni ambientet në të cilat është transferuar zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (unë e kam gjetur në këto ambiente, është transferuar 3 muaj më parë), ka mungesë absolute të standardeve minimale, që duhet të ofrojë një institucion i këtij niveli.

Fatmir Xhafaj – Ministria e Financave?

Bashkim Fino - Unë e kam mik Besnikun dhe e di se ai ka aftësi të mira menaxhuese dhe organizuese. Të na e tregojë këtë edhe te ky institucioni i ri. Le të bëjë një organigramë të re me këta 3 veta që i shtuam. Ai nuk mund të vazhdojë me organigramën e vjetër. Pasi ta paraqesësh, me siguri që do të jesh i kënaqur me 3 veta shtesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Besnik Dervishi – Zoti Fino më lexon, si gjithmonë mendjen. Ne e kemi përgatitur edhe organigramën e re, por për shkak se duhet të kalojë më parë numri i punonjësve në ligjin e buxhetit. Por edhe organigrama e re, sado jemi përpjekur ta shtrëngojmë dhe ta rrudhim, na ka dalë me 36 veta.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Mirë është që organigrama e re të jetë sa më efiçente dhe të vihen disa njerëz para përgjegjësisë për shkeljet që janë në këtë fushë dhe pastaj, zoti Fino do ta miratojë.

Ministria e Financave a ka ndonjë koment?

Gelardina Prodani – Ne jemi dakord me komentin e relatorit.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Është pozitive që ju të merreni vesh me relatorin, që të bëni shtesën.

Faleminderit, zoti Dervishi!

Në fund do të bëhet analiza përkatëse e çdo komenti.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me Komisioni Qendror të Zgjedhjeve.

Skënder Vrioni – Faleminderit!

I nderuar kryetar i Komisionit të Ligjeve,

Të nderuar deputetë,

Duke ju falënderuar dhe vlerësuar për ftesën në kuadër të të gjitha institucioneve të pavarura, për të dëgjuar dhe diskutuar rreth çështjeve dhe problematikave që na shqetësojnë në shqyrtimin e këtij projektligji mjaft të rëndësishëm, siç është miratimi i projekt-buxhetit, shprehemi parimisht dakord me fondet e miratuara

për funksionimin e KQZ-së për vitin 2015. Ky vit korrespondon me një vit zgjedhor. Gjithashtu, e gjejmë me vend të falënderojmë ekspertët e Ministrisë së Financave, që kanë hartuar projektligjin, për bashkëpunimin permanent me KQZ-në, në të gjitha fazat e negocimit, që kemi bërë me këtë institucion.

Fatmir Xhafaj – Këtë shkresë që po lexoni, e kemi pa firmën e Lefterisë. I thoni Lefterisë të firmosë, kur i nis shkresat Kuvendit!

Skënder Vrioni – Kjo është shkresë e dërguar në mënyrë elektronike, sepse kështu na e kishin kërkuar.

Fatmir Xhafaj – Mirë do të ishte të vinte vetë.

Skënder Vrioni – Aktualisht, kryetarja është në një procedurë vendimmarrjeje dhe e ka të pamundur të vijë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por është ajo që thotë zoti Majko: më i rëndësishëm se buxheti, s'besoj se kishte, por ka një javë që është njoftuar për këtë gjë dhe duhet të thoshte: "Më falni, se unë s'mund të vi në këtë orë!". Neve na mjafton edhe prezenca juaj. Por nuk ka nevojë të lexohet i gjithë materiali, se e kemi përpara. Më thoni nëse keni ndonjë kërkesë jashtë këtij materiali. Unë e kuptova që jeni të kënaqur. Kjo është pozitive.

Skënder Vrioni – Problematika aktuale kemi lidhur me faktin që me një vendim të posaçëm të KM, institucioni i KQZ-së do të ndryshojë ambient, do të shkojë te ambientet e ish-Ministrisë së Mbrojtjes, ku na është dhënë një godinë 2-katëshe, e cila do të administrohet nga ne. Në këtë kontekst, meqë projekt-buxheti ishte përgatitur para këtij vendimi, kërkojmë një fond të nevojshëm për rikonstruktimin e kësaj godine, meqë ambientet e kësaj godine janë krejtësisht të pamjaftueshme dhe jashtë funksionit për objektin e punës së KQZ-së. Në këto kushte jemi duke kryer procedurat përkatëse të prokurimeve, duke filluar me analizën e projektit dhe mbi bazën e kësaj analize do të dalë fondi për rikonstrukcionin e godinës dhe për blerjen e projektit. Në momentin që do të dalë ky fond-limit i nevojshëm, do t'ia bëjmë prezent Ministrisë së Financave, për ta akorduar fondin, në mënyrë që të zhvendosemi sa më parë në godinën e re, për arsye se po afron edhe data e dekretimit të zgjedhjeve dhe duhet të vendosemi atje, sa më parë që të jetë e mundur.

Shqetësimi i dytë është i lidhur me automjetet që ka në dispozicion KQZ-ja, të cilat përveç faktit që janë prodhim i vitit '96, janë tejet të amortizuara dhe vetëm kostot e shërbimit, kushtojnë më shumë se blerja e re e tyre. Meqë KQZ-ja ushtron kontroll dhe mbikëqyr të gjitha fazat ku kalon procesi zgjedhor para ditës së zgjedhjeve, ditën e zgjedhjeve, por dhe pas ditës së zgjedhjeve, këto mjete janë mjaft të domosdoshme për funksionimin normal punës së KQZ-së.

Për këtë kërkojmë një fond minimal prej 5 milionë lekësh të rinj, që për hir të së vërtetës, është rënë dakord me Ministrinë e Financave.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Faleminderit!

I kemi edhe të shkruara këto kërkesa.

Ç'mendim keni, zoti Fino?

Bashkim Fino – Unë do të thosha se projekt-buxheti i KQZ-së është në përgjithësi korrekt. Kërkesat që bëjnë drejtuesit e KQZ-së në këto momente, s'kanë të bëjnë me këtë projekt-buxhet, sepse nuk është bërë akoma transferimi i godinës dhe në momentin që do të bëhet, me të drejtë kërkohet nga ju rikonstruksioni i godinës, ku do të shkoni. Janë hapësirat e mundshme dhe me fondin rezervë që mund t'ua japë qeveria, mund t'ua zgjidhi këtë situatë. Ne s'mund të parashikojmë në buxhetin e tanishëm, kur nuk është kryer akoma një vendim i tillë.

Shikoj pasqyrën dhe më vjen mirë që janë parashikuar fondet dhe kostot e zgjedhjeve të pushtetit vendor të vitit 2015, prej 600 milionë lekësh, por s'e di se nga kanë dalë këto llogari nga ju, apo nga Ministria e Financave?

Unë kam 2 vërejtje për këtë projekt-buxhet, zoti kryetar:

E para, do të jenë kosto shumë minimale, sepse s'do të ketë më fleta votimi për kryetarë komune/bashkie dhe këshilla bashkie/komune për 400 njësi, por do të kemi për 61 njësi. Pra, do të kemi 61 njësi vendore dhe është një kursim maksimal në raport me shumën që do të harxhonim nëse do të bënim zgjedhje për 385 njësi vendore, që janë aktualisht. Ndoshta, këto duhet të jenë të monitorueshme nga Ministria e Financave.

E dyta, asnjë institucion kushtetues nuk ka ardhur këtu të thotë se e ka kaq numrin e punonjësve dhe kërkoj ulje të numrit të punonjësve. Të gjithë kanë kërkuar

rritje të këtij numri. Më bën përshtypje numri shumë i madh të punonjësve të KQZ-së. Ai sot është 55. Problemi është se KQZ-ja angazhohet në mënyrë maksimale, një herë në dy vjet për 15 ditë, kur ka zgjedhje të përgjithshme dhe zgjedhje vendore. Përse nuk praktikohet marrja e punonjësve me kohë të kufizuar? S'mund të mbash 55 veta në një institucion, që s'ka ndonjë punë të madhe pjesën më të madhe. Çfarë bëjnë këta 55 veta? Hiq 7 anëtarët e KQZ-së dhe financat që po interesohen për buxhetin këtu. Po ata 40 të tjerët çfarë po bëjnë në këtë moment? Unë them se Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe qeveria në tërësi, duhet ta shikojë riorganizimin në tërësi të të gjitha institucioneve kushtetuese, që na vijnë e na kërkojnë me insistim, shtim të numrit të punonjësve, ndërkohë, që mund të ketë hapësira për ta shkurtuar numrin e punonjësve, për ta bërë më efektive punën, ashtu siç duhet të jetë.

Këto kisha dhe në fund theksoj se buxheti për KQZ-në është shumë i mirë, madje është me rezerva të mëdha për zgjedhjet lokale të vitit të ardhshëm. Le të planifikohet kështu, ndërkohë ministria të marrë përsipër që nga fondi rezervë të ndërhyhet, kur të ndryshojnë ambientin. Natyrisht, qeveria duhet të ndërhyjë për rregullimet e nevojshme të ambienteve, sepse s'mund të venë në ambiente të parregulluara.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Kush e miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të KQZ-së?

Skënder Vrioni – Atë e miraton KQZ-ja. Për hir të së vërtetës, duke qenë se kemi kërkuar si administratë ndryshimin e strukturës në drejtim të rritjes së numrit të punonjësve, në përputhje me vendimet e Këshillit të Ministrave, për arsye se struktura që kemi, nuk është në përputhje me një VKM, por edhe në lidhje me funksionin që kryen administrata e KQZ-së dhe nuk është vetëm Drejtoria e Financës që kryen aktivitet, por janë disa drejtori që kryejnë aktivitete të ndryshme, në lidhje me organizimin e punës së KQZ-së dhe në këtë kontekst kjo strukturë nuk ka kaluar, për arsye se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka qenë me një strukturë jo të plotë, pasi duhet një shumicë e cilësuar numrash për të ndryshuar strukturën.

Fatmir Xhafaj – A ka komente financa? Jo.

Mbani gjërat shënim. Faleminderit!

Gjithsesi, këshilltarët, bashkë me Monitorimin, një memo për të parë se si bëhet struktura dhe se si nuk bëhet, me këtë diskutim që u bë këtu, nëse mund të bëhet një diskutim se si duhet të jetë. Ka të drejtë zoti Fino, ka disa institucione të kësaj natyre që kanë punonjës dhe punonjësit rrinë tërë vitin, sepse ngarkesën e kanë në periudhë kohore shumë të shkurtër.

Faleminderit!

E mbyllim këtu me KQZ-në.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Zonja Baraku, së bashku me drejtoreshën e Financës...

Këshilltarja? Edhe këshilltare kanë komisionerët?

E kemi përpara shkresën tuaj dhe komentet që ka bërë Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura. Gjithsesi, shkurt, një prezantim një prezantim dhe komentet që keni për projektin.

Irma Baraku – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Fillimisht dua ta falënderoj Ministrinë e Financave për ruajtjen e mbështetjes financiare për zhvillimin e aktivitetit të institucionit. Buxheti është në të njëjtën vlerë si vitin e kaluar, kështu që të paktën të njëjtin nivel veprimtarie kemi mundësi ta mbështesim nëpërmjet këtij buxheti. Kemi bërë vetëm një kërkesë shtesë, për sa i takon mundësisë për të shtuar një person te sektori i marrëdhënieve me publikun. Për disa arsye.

E para, sepse ndër kompetencat e komisionerit janë edhe çështjet që kanë të bëjnë me ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin. Sektori i marrëdhënieve me publikun aktualisht ka vetëm dy persona. Jemi detyruar që të angazhojmë edhe struktura të tjera brenda institucionit, por edhe struktura që e mbështet këtë sektor në fakt zhvillon një aktivitet shumë të gjerë, që ka të bëjë edhe me përfaqësimin e institucionit nëpër gjykata,

edhe me realizimin dhe hartimin e rekomandimeve legislative, apo opinioneve të ndryshme, si dhe me raportimet e vazhdueshme që për shkak se kanë bëjnë me të drejta e njeriut dhe mosbarazisë e diskriminimit janë edhe ndër pesë prioritetet që ka shteti shqiptar në procesin e integritetit, i takon të raportojë në vazhdimësi, kështu që është e pamundur që kjo drejtori që ta mbështesë në kërkesën dhe nivelin e duhur sektorin e marrëdhënieve me publikun. Vetë sektori i marrëdhënieve me publikun nuk shërben vetëm për realizimin e marrëdhënieve të institucionit me institucionet e mediave të tjera, por ka edhe funksione që kanë të bëjnë edhe me pritjen e publikut. Kanë një zyrë ku presin ankesat dhe pretendimet e atyre që pretendojnë se janë viktimat të sjelljeve diskriminuese.

Kemi kërkuar një person shtesë. Vlera apo kostoja financiare në fakt është në përputhje me tavanet që kemi pasur të përcaktuara për vitin 2015. Është 500 mijë lekë të reja më poshtë sesa është ky tavan.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka komente?

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Ashtu siç tha komisionerja, është pothuajse në të njëjtin nivel. Komisionerja ka kërkuar dy punonjës shtesë, dhe jo një. Me një kosto 2,5 milionë. Ka evoluar në mendimin e saj dhe tani thotë se kërkon një shtesë. Ajo e njeh më mirë këtë institucion, por unë do ta quaja të rëndësishme edhe zyrën rajonale që ka kërkuar. Nuk e di nëse do ta bënte këtë tolerim Ministria e Financave, natyrisht së bashku me fondin e pagave. Edhe projektbuxheti afatmesëm i vitit 2018 totalin e shpenzimeve e ka llogaritur 38 milionë. Ministria e Financave mund ta rregullojë një shifër kaq të vogël sa kërkohet, pa na vënë ne në provë.

Fatmir Xhafaj – Kam një gjë, zoti Fino. Mos ka ardhur momenti që t'u bëjmë një rishikim të gjitha këtyre strukturave, siç kemi thënë? Po shikoj disa struktura që janë të çuditshme. Kabineti që s'i kuptoj dot. Sidoqoftë, kjo është çështje tjetër.

Financat, për ndërhyrjen e relatorit?

Specialiste – Po e mbajmë kërkesën në rekordet tona dhe do ta akomodojmë në kohën që do të rakordojmë të gjitha kërkesat që do të marrim nga komisionet e tjera.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Baraku!

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me Institutin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

Zoti Tufa është drejtor ekzekutiv i këtij instituti. Është këtu së bashku me zonjën Zoica Plaku, drejtore e Financës.

Zoti Tufa, të lutem, një përmbledhje të pjesës që ju takon ju nga ky projektbuxhet dhe nëse keni ndonjë koment për të bërë, për të qenë në vëmendjene relatorit dhe të Ministrisë së Financave.

Agron Tufa – Më lejoni t’ju përshëndes, zoti kryetar dhe deputetë të pranishëm!

Do të jem shumë lakonik. Nuk kam shumë gjëra për të thënë. Jemi shumë të kënaqur nga buxheti i miratuar vitin e kaluar, prandaj ju falënderoj! Besoj se e kemi përdorur me mjaft nikoqirllëk, kryesisht me botimin e studimeve dhe librave që kemi botuar sipas natyrës sonë, të Institutit të Studimeve.

Mbase tingëllon pak paradoks, sepse dëgjova zotin Fino që kishte logjikën normale të numrit të punonjësve, nuk kam asnjë gjë...

(Mungesë incizimi.)

...10 studiues dhe arkivistë, së bashku. Përfytyrojeni se sa të shumta janë arkivat, ku ne...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Laj – thaj, 10 jemi. Domethënë 5 janë shërbime mbështetës, por ato nuk i kemi për punë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gjithsej jemi 5 studiues dhe 5 arkivistë. Këto 5 arkivistë nuk dinë çfarë të bëjnë më përpara. Të furnizojnë studiuesit brenda dhe jashtë Institutit me materiale... Ne po bëjmë një fjalor enciklopedik shumë të gjerë, që po vazhdon me volume. Është krejtësisht e pamundur, më besoni... Ideja ishte që të krijonim një arkiv të mirë, sipas profilit, ku çdo studiuese të vinte të merrte materiale. Sikundër është edhe një bibliotekë shkencore, ku të vini e të gjeni me shpejtësi informacionin e duhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si fillim, e them, asgjë. Duke parë situatën financiare në përgjithësi, nuk guxuam ta kërkojmë. Kërkesa jonë është: 5 njerëz që të punojnë 8 orë rresht në arkiva.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jemi shumë të kënaqur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ndoshta jam unë i gabuar. Edhe vitin tjetër, ju kemi mbështetur, në mos gabo, me shtesë buxheti. Apo e kam gabim?

Agron Tufa – E thashë, jemi shumë të kënaqur.

Fatmir Xhafaj – Po nuk e kemi pasur kërkesën për numrin e punonjësve vitin e kaluar.

Agron Tufa – Nëse ju kujtohet, e thashë edhe vitin e kaluar. Bëra një krahasim larg e larg, jo drejtpërdrejt: më i vogli i instituteve të rrjetit në Europën Qendrore e Lindore, që është Bullgaria, ka 122 specialistë. Ne kemi 15, bashkë me shërbimet mbështetës. Megjithatë, jemi të kënaqur. Jetojmë në një kontekst...

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino?

Bashkim Fino – Është e vërtetë që numri i punonjësve është 15 vetë. Ndarjen e kanë, thanë vetë: 10 në arkiv dhe 5 në shërbime.

Siç thatë ju, zoti kryetar, ne kujtohem për institucionet e varësisë atëherë kur vjen buxheti. Duhet t'i marrin në një lloj analize, për të mirën e punës së tyre, shumë herë më përpara se të vijë buxheti dhe të kemi një dakordësi të gjithë bashkë për strukturat që ato kanë, duke i krahasuar edhe me strukturat që kanë sot në Europë, me ndonjë përafrim që mundemi. Nëse do ta bëjmë me kujdes këtë në vitin 2015, të jeni të bindur që buxheti pasardhës do të jetë shumë interesant për nga numri i punonjësve. Unë si relator mund ta mbështes për shtesën e 4-5 vetave, por kjo është një çështje që duhet ta ketë në konsideratë Ministria e Financave.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

A ka diçka nga kolegët? Jo.

Financat?

Gelardina Prodani – Po e marrin në konsideratë, për ta vlerësuar më tej.

Fatmir Xhafaj – Sigurisht që duhet dhënë diçka. Brenda mundësive. Edhe për t'i dhënë rëndësinë e vlerën që ka dashur ligjvënësi që kur e ka krijuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arkiva është me letër dhe po dublohet edhe dixhitale, plus sajti i imtësishëm që po hidhet, për të aksesuar gjithë...

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Gjithë të mirat!

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me Avokatin e Popullit, zotin Totozani.

Ai ka ardhur së bashku me sekretarin e Përgjithshëm, zotin Zenelaj.

Zoti Totozani, një paraqitje të shkurtër, pasi ne i kemi përpara edhe praktikën e Financave edhe Shërbimin e Monitorimit.

Igli Totozani – Së pari, doja t'ju falënderoja për këtë seancë dëgjimore, e nevojshme që të shprehim kërkesat tona.

Po mundohem që të jem sa më i drejtpërdrejtë në ato kërkesa që kemi.

Së pari, në fondin e pagave kemi vënë re një diferencë prej 500 lekësh, të cilën mund ta sqarojmë vetë me ministrin e Financave. Nuk është një çështje që mund ta ngremë këtu.

Së dyti, ju e dini se një nga problemet kryesore që kemi prej dy vjetësh është hapja e zyrave rajonale. Në kuadër të projektit danez, Avokati i Popullit ka hapur 7 zyra rajonale në qytete kryesore të Shqipërisë, të cilat rrisin aksesin e qytetarëve, në mënyrë që të mos harxhojnë para deri në Tiranë, por të gjejnë mundësitë e tyre pranë zyrave tona rajonale. Janë hapur zyra rajonale në Sarandë, në Dropull, për shkak të minoritetit, në Pogradec, në Shkodër, në Fier, në Kukës, në Berat.

Përfitoj nga rasti, t'ju them që zyrat janë të pajisura nga projekti danez. Deri tani e kemi mbuluar me shoqëri civile, qytetarë që paraqiten në ato zyra një ditë në javë. Marr shkas nga diskutimi i komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e cila mendoj se ka të njëjtat nevoja. Kemi biseduar para disa kohësh edhe me drejtoreshën e Komisionit të Ndihmës Juridike Falas, e cila gjithashtu ka nevojë për zyra të tilla dhe ndoshta është rasti

për t'u menduar që këto zyra të Avokatit të Popullit të jenë zyra për të tri institucionet. Me Komisionin e Ndihmës Juridike kemi rënë dakord. Mendojmë se edhe kursejmë, edhe u shërbejmë qytetarëve, ku të tri komisionet, ndoshta edhe ndonjë institucion tjetër, mund të specializojmë një individ, i cili të punoj për të tre.

Kërkesa tjetër është për rastin e një punonjësi për specialit finance, sepse menaxhojmë jo vetëm buxhetet e shtetit, por edhe projektin danez. Kemi vetëm një punonjës finance në institucion. Nëse arrijmë një marrëveshje me Ministrinë e Financave, me mbështetjen tuaj, këto zyra rajonale të përmbushin nevojat e qytetarëve, mendoj se do të ishte një zgjidhje edhe kursimtare, edhe e nevojshme. Ndoshta mund të futet edhe komisioneri për të Dhënat Personale. Kemi mundësitë që të specializojmë edhe jashtë Shqipërisë.

Faleminderit!

Bashkim Fino – Të dhënat e pasqyrës tregojnë që të dhënat financiare janë korrekte, nuk ka probleme. Ministria ta verifikojë që pagat të jenë korrekte për tërë vitin. Sipas evidencës, Avokati ka kërkuar një shtesë prej 10 punonjësish, kërkesë që nuk është akomoduar. Shpenzimet korente mbeten atë që kanë qenë një vit më parë. Kërkesa për një punonjës finance, për financat e veta dhe projektin danez, është e re. Nuk e kam të pasqyruar, por e mbajta shënim. Ngritja e zyrave rajonale për t'u shërbyer këtyre katër institucioneve është një kërkesë racionale. Kjo është në kuadrin e diskutimit që bëmë bashkë në fillim, zoti kryetar, që duhet t'i shikojmë strukturat e të gjitha institucioneve, që të mos kenë përplasje. Propozimi i fundit është shumë i interesant, por nuk mund të themi gjë dot tani. Nëse kemi kohë derisa ta miratojmë buxhetin nen për nen, ta shohim. Për propozimin e financës, do të thosha se është një kërkesë shumë modeste dhe nuk do të ishte keq që ta shihnim.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Zonjat përfaqësuese të Ministrisë së Financave?

Gelardina Prodani – Me këtë organizimin e ri do ta shikonim edhe këtë kërkesë të punonjësit të financës. Ne si financiere, duam në fakt t'i forcojmë financat e institucioneve të pavarura. Është një kontroll më shumë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Artur, ju të Monitorimit, dua që sot të bëni një konsultë. Në pamje të parë, më duket se mund të jetë racional propozimi që bën zoti Totozani.

E para, të kontaktoni me tri institucionet e tjera.

E dyta, të gjeni se cili është mekanizmi që do t'i përbashkojë.

Mbasi të bëhet një konsultë me të katër institucionet, të bëni një dokument, që të keni mundësi të hënën, ose të martën, t'ia kaloni relatorit dhe Ministrisë së Financave. Nëse gjendet mirëkuptimi, një zgjidhje ligjore dhe administrative, ku përshtatet qëllimi dhe menaxhimi, ne mund ta mbështesim.

Ta provojmë.

Zoti Totozani.

Igli Totozani – Ju falënderoj për mirëkuptimin!

Jemi institucione me natyra të përafërta, që mbulojmë pak a shumë problematika të njëjta. Kjo mund të zgjidhet me një memorandum bashkëpunimi midis institucioneve. Duke qenë se janë në kuadër të projektit danez, duhet të ketë një lloj ombrelle nga Avokati i Popullit, për arsye se justifikon shpenzimet e bëra për zyrat dhe e dyta kemi menduar trajnimet që duhen bërë në Danimarkë, në kuadër të projektit danez.

Fatmir Xhafaj – Kjo është se si do të bini dakort me njëri-tjetrin. Nga pikëpamja funksionale, le ta shikojë Drejtoria e Monitorimit, nga pikëpamja organizative dhe buxhetore, duhet të bjerë dakord zoti Fino, që do ta trajtojë më Ministrinë e Financave.

Igli Totozani – Ju na këshilloni që të biem në një marrëveshje brenda natës?

Fatmir Xhafaj – Të gjeni një zgjidhje.

Faleminderit!

Mbyllëm me Avokatin e Popullit.

I mbyllim të gjitha seancat dëgjimore që kishim lidhur me projektbuxhetin.

Sot votuam në parim projektbuxhetin e shtetit për vitin 2015, për t'i hapur rrugë shqyrtimit të tij në seancë plenare.

Votuam në parim ligjin nr. 9975 “Për taksat kombëtare”.

Votuam në parim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975 “Për taksat kombëtare”.

Votuam në tërësi projektligjin “Për faljen e kamatëvonesave e gjobave “Për kontributet e detyrueshme dhe sigurimeve shoqërore të papaguara dhe personave të vetëpunësuar në bujqësi.

Dëgjuam në seancë dëgjimore ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ILDKP-në, KQZ-në, Avokatin e Popullit, komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Institutin e Studimeve të Krimeve dhe të Pasojave të Komunizmit dhe komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil.

Gjithashtu, dëgjuam edhe Ministrinë e Financave, për komentet dhe vlerësimet që pati. Falënderoj sekretaren e Përgjithshme dhe zonjën drejtoreshë për konstruktivitetin në këtë diskutim, për sensin pozitiv të të parit të gjërave, me qëllimin e të bërit të nevojshëm atje ku duhet!

Falënderoj edhe relatorin, për angazhimin, për punën shumë të kujdesshme që ka bërë! Edhe kolegët, edhe median që na ka ndjekur.

Faleminderit!

Fundjavë të mbarë!

Javën që vjen është diskutimi dhe votimi në parim në seancë plenare, ditën e hënë, i buxhetit.

Ditën e martë, së bashku me Ministrinë e Financave, nën drejtimin e relatorit, do të jemi këtu për të mbyllur raportin përfundimtar dhe votimin nën për nen të buxhetit. Në ora 10:00.

Edhe një herë, faleminderit!

Fundjavë të mbarë!

MBLEDHJA MBYLLET